



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2533/24

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI146/24

Parashtrues

Avni Tahiraj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avni Tahiraj, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe lirit themelore të tij të garantuara me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] 10 [Ekonomia], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 korrik 2024, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
6. Më 25 korrik 2024, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI146/24 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI146/24 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Më 26 korrik 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe i kërkoi që në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh: (i) të specifikonte aktin që e konteston; (ii) të specifikonte të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur dhe (iii) të bashkëngjiste dokumentet e nevojshme.
8. Më 13 gusht 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë të re, mirëpo nuk e specifikoi aktin që e konteston dhe nuk bashkëngjiti asnjë dokument.
9. Më 11 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës vendimin për refuzimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës, në formularin të cilin e ka dorëzuar në Gjykatë, thekson se në vitin 2006 kishte shkruar disa komente në portale në lidhje me çështjen e bashkimit kombëtar. Pas kësaj, ai thekson se nisën hetimet ndaj tij për terrorizëm.
11. Parashtruesi i kërkesës thekson se në vitin 2017 kishte kërkuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës që të trajtonte rastin e tij, sepse dyshonte se ishte nën hetime. Parashtruesi i kërkesës thekson se kishte drejtuar kërkesa edhe në institucione të tjera, përfshirë

EULEX-in dhe Policinë e Kosovës dhe kishte shprehur gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar në rast se ishte i dyshuar.

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon që asnjëherë nuk mori ndonjë përgjigje nga institucionet shtetërore në lidhje me shqetësimet e tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës i ka përmendur nenet 4, 10, 22 dhe 24 të Kushtetutës mirëpo nuk ka ofruar argumente dhe pretendime konkrete në lidhje me shkeljen e tyre.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 47 dhe 48 të Ligjit.

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

16. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullave 25 dhe 54 të Rregullores së punës.

Rregulli 25

[Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve]

[...]

(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;

(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;

(g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

Rregulli 54

[Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

(1) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur Gjykata përcakton se pretendimi:

(a) nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm; ose

(b) nuk përfaqëson një kontest.

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]

17. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thekson se në vitin 2006 kishte shkruar disa komente në mediat elektronike dhe për këtë arsye ishte nën hetime penale. Në formularin që e dorëzoi në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës nuk specifikoi ndonjë akt të autoritetit publik që e konteston.
18. Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të plotësonte dhe qartësonte kërkesën e tij: (i) të specifikonte aktin e autoritetit publik që e konteston; (ii) të specifikonte të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; dhe (iii) të bashkëngjiste dokumentet e nevojshme në lidhje me rastin e tij. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë të re në Gjykatë mirëpo nuk specifikoi ndonjë akt të autoritetit publik që e konteston dhe nuk ofroi dokumentet e kërkuara.
19. Gjykata thekson se, rregulli 54 (2) (a) i Rregullores së punës parasheh që Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është jo e plotë dhe e paqartë, përkundër kërkesës së Gjykatës ndaj parashtruesit të kërkesës për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën e tij.
20. Gjykata rithekson se, barra për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes juridik për t'i ngritur pretendimet e tyre. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i shpall këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota dhe i refuzon me procedurë të shkurtër (shih, rastet e Gjykatës [KI01/23](#), parashtrues Amir Hamza, Vendim për refuzim të kërkesës i 14 dhjetorit 2023, paragrafi 42; [KI90/20](#), parashtrues Arben Boletini, Vendim për refuzimin e kërkesës i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25).
21. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është jo e plotë dhe e paqartë, dhe rrjedhimisht kërkesa refuzohet me procedurë të shkurtër në përputhje me rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani